



Programi i Trajnimit për Certifikimin e Udhërrëfyesve Lokalë për zonën Mokër-Gorë të bashkisë Pogradec

Jemi në kërkim të 5 të rinjve që jetojnë në katër Njësitë Administrative të bashkisë Pogradec: Proptisht, Trebinjë, Velçan dhe Dardhas. Të rinjtë do të marrin pjesë në trajnimin e certifikimit si udhërrëfyes lokal për zonën Mokër-Gorë.

Trajnimi do të ofrohet nga një qendër e certifikuar trajnimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Programi përfshin 320 orë trajnimi teorik dhe praktik. Programi i trajnimit do të ofrohet gjatë muajve prill-maj 2024.

ANRD do të mbulojë tarifën e trajnimit dhe do të prokurojë dhe dorëzojë NJ.A. Proptisht për përdorim nga udhërrëfyesit, një aparat fotografik dhe një biçikletë malore.

Afati përfundimtar për aplikim: 15 prill.

Linku për të aplikuar: [Formulari](#)

Më poshtë po ju informojmë rreth projektit.

Në kuadër të projektit *“Forcimi i partneriteteve për zhvillimin vendor përmes fuqizimit të rrjeteve kombëtare dhe rajonale të zhvillimit rural në Ballkanin Perëndimor”* zbatuar nga ANRD dhe mbështetur financiarisht nga projekti rajonal i GIZ *“Mbështetje për diversifikimin ekonomik të zonave rurale në Evropën Juglindore (SEDRA)”*, shpallim thirrjen për aplikim për pjesëmarrje në trajnimin për certifikimin e udhërrëfyesve lokalë për të rinjtë që jetojnë në territorin e zonës Mokër-Gorë, specifikisht në njësitë administrative: Proptisht, Trebinjë dhe Velçan dhe Dardhas.

Kjo mundësi për të rinjtë e zonës ofrohet në kuadër të mbështetjes që ofrohet nga ANRD për Grupin Vendor të Veprimit Mokër-Gorë. GVV Mokër-Gorë ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit Vendor për periudhën 2024-2027 me synimin për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të zonës “Leader1”. Kjo zonë përfshin territorin e katër njësive administrative të Bashkisë Pogradec, konkretisht: Dardhas, Trebinjë, Velçan dhe Proptisht.

Pse ofrohet një mbështetje e tillë në Mokër-Gorë?

Turizmi malor paraqet një mundësi të rëndësishme për zhvillimin social dhe ekonomik të zonës Leader të GVV-së Mokër-Gorë, falë bukurive natyrore, klimës, trashëgimisë së pasur kulturore dhe historike si dhe traditës së mikpritjes. Zhvillimi i turizmit përfaqëson një fushë prioritare e



Implemented by:
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



identifikuar në Strategjinë e Zhvillimit Lokal të GVV-së Mokër-Gorë. Turizmi malor krijon kushte shumë të favorshme për shtigje ecjeje dhe biçikletash, duke ofruar kështu mundësi punësimi për popullsinë vendase, veçanërisht për të rinjtë, duke adresuar trendin gjithnjë në rritje të largimit të tyre nga zona.

Megjithatë, zhvillimi i turizmit është ende në fazat e hershme dhe banorët vendas po ndërgjegjësohen për rëndësinë ekonomike të potencialit të zonës. Për të përfutur plotësisht nga ky potencial, popullsia lokale ka nevojë për mbështetje për të zhvilluar aftësitë dhe njohuritë në lidhje me ofrimin e shërbimeve profesionale për turistët, duke përfshirë dhe informacion rreth atraksioneve turistike, historike dhe atyre të trashëgimisë kulturore të zonës. Në të gjithë zonën e Mokër-Gorës mungojnë udhërrëfyes turistike lokalë të cilët të jenë profesionistë të kualifikuar dhe të licencuar për këtë aktivitet.

Objektivat

Mbështetja për GVV Mokër-Gorë fokusohet në adresimin e potencialit të pashfrytëzuar të turizmit malor në zonën Leader të GVV-së. Kjo mbështetje synon të krijojë një rrjet udhërrëfyesish turistike profesionistë të certifikuar (pesë të rinj vendas) në zonë dhe të inkurajojë angazhimin e tyre të ardhshëm në turizëm, duke kontribuar kështu në qëllimet e përgjithshme të zhvillimit social dhe ekonomik të përshkruara në Strategjinë e Zhvillimit Lokal. Duke investuar në aftësitë dhe kapacitetet e të rinjve, mbështetja jo vetëm që adreson nevojën evidente për udhërrëfyes profesionistë, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin e kapitalit njerëzor në komunitet.

Kjo mbështetje për GVV Mokër-Gorë është në linjë me qëllimin e promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm në zonë duke shfrytëzuar asetet e saj natyrore dhe kulturore për turizëm. Në mënyrë të veçantë, mbështetja kontribuon në objektivin specifik të Strategjisë pasi synon të zhvillojë dhe promovojë turizmin rural në zonën Leader përmes ofrimit të shërbimeve turistike profesionale, duke përfshirë ture me udhërrëfyes, mundësitë e akomodimit dhe aksesin në atraksionet turistike.

Rezultati i pritshëm

Përmes Programit të Trajnimit për Certifikimin e Udhërrëfyesve Lokal për zonën Mokër-Gorë të bashkisë Pogradec synohet trajnimi dhe certifikimi i një grupi të vogël prej pesë të rinjsh si udhërrëfyes turistike profesionistë në zonën e Mokër-Gorës.

Këta të rinj të certifikuar si udhërrëfyes do të përmirësojnë shërbimet dhe informacionin turistik, do të përmirësojnë aksesin në atraksionet turistike dhe do të ofrojnë ture, duke kontribuar kështu në zhvillimin dhe promovimin e turizmit rural në zonën Leader.

Mbështetja e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural do të përfshijë:

Mbulimin e pagesës prej 350 Euro të tarifës së regjistrimit në kursin e trajnimit për udhërrëfyes lokal;



Blerjen e një aparati fotografik dhe një biçikletë malore për t'u përdorur nga të rinjtë e certifikuar për t'u angazhuar konkretisht në promovimin e zonës si një destinacion turistik. Aparati fotografik dhe biçikleta do t'i dorëzohen Njësisë Administrative Proptisht për të siguruar që këto mjete përdoren në mënyrë të barabartë nga udhërrëfyesit turistikë lokalë.

Kriteret e pranimit:

Për të pasur akses në programin e trajnimit, aplikantët duhet të përmbushin kriteret e treguara më poshtë (“kushtet e detyrueshme”):

- të jetë një i/e ri/e (18-35 vjeç, në momentin e aplikimit);
- të jetë banues në zonën e GVV Mokër-Gorë;
- të jetë zotërues i diplomës së shkollës së mesme;
- të zotërojë Certifikatën për Dhënien e Ndhmës së Parë
- të jetë i përkushtuar për të përfunduar programin e trajnimit deri në certifikim si udhërrëfyes.

Të rinjtë e interesuar për të marrë pjesë në këtë program duhet të plotësojnë formularin e aplikimit dhe të ngarkojnë brenda formularit dokumentat e mëposhtme:

- a. Dokument identifikimi të vlefshëm (kopje të kartës së identitetit ose pasaportës)
- b. Kopje e diplomës së shkollës së mesme
- c. Vërtetim banimi
- d. Dëshmi Penaliteti
- e. Certifikatë për Dhënien e Ndhmës së Parë

Për informacione të mëtejshme na kontaktoni në: info@anrd.al

Vetëm aplikantët që dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe formularin e aplikimit të plotësuar do të merren në konsideratë për vlerësim.

Do të kontaktohen vetëm të rinjtë që përzgjidhen për programin e trajnimit.